



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e 12 (dymbëdhjetë) qershorit, Ditës së Çlirimit të Kosovës, dhe shënimin e Njëqindëzyzetepesë (145) Vjetorit të Lidhjes së Prizrenit në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Ministri i Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare;
 - 1.4. Ministrja e Drejtësisë, anëtare;
 - 1.5. Ministri i Punëve të Brendshme, anëtar; dhe
 - 1.6. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues, Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4. Komandanti i Forcës së Sigurisë, anëtar;
 - 2.5. Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.6. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar;
 - 2.7. Përfaqësues i Familjes Jashari, anëtar; dhe
 - 2.8. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Me kërkesë të Kryesuesit të Këshillit Organizativ, mund të themelohen nën-grupe për realizimin e aktiviteteve sipas nevojave të Këshillit Organizativ.
4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes që në afat prej 3 (tre) muaj nga miratimi i kësaj Strategjie, të bëjë hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë.
3. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/143
Datë: 24.05.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Këshilli Ndërministror për Kontroll të Duhanit me qëllim të mbrojtjes së shëndetit, parandalimit, vetëdijesimit dhe edukimit të shoqërisë duke njoftuar mbi efektet e dëmshme të duhanit me këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Arben Vitia - Ministër i Shëndetësisë, kryesues;
 - 1.2. Znj. Azize Daku - përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë, anëtare,
 - 1.3. Znj. Laura Lutfiu - Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - 1.4. Znj. Antoneta Azemi - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtare,
 - 1.5. Z. Blirind Danjollari - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.6. Znj. Vlora Limani - Hajnuni - Ministria e Drejtësisë, anëtare,
 - 1.7. Z. Kushtrim Krasniqi - Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 1.8. Z. Gent Zeqiri - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
 - 1.9. Z. Eljasi Surdulli - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës anëtar;
 - 1.10. Z. Isuf Cikaqi - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.11. Z. Onur Canhasi - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 1.12. Dr. Naser Ramadani - Profesionistët Shëndetësor, anëtar;
 - 1.13. Znj. Behare Bajraktari, përfaqësuese e mjeteve të informimit, anëtare;
 - 1.14. Z. Agron Bytyqi - Shoqëria Civile, anëtar,
 - 1.15. Z. Besim Kodra - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Të gjithë Kryeinspektorët e inspektorateve të përmendura në Ligj janë anëtarë të Këshillit Ndërministror sipas funksionit në cilësinë e ekspertëve.
3. Këshilli detyrat e tij i kryen konform nenit 13 të Ligjit Nr.04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.07/134 i datës 17 qershor 2013 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.07/25 të datës 29 prill 2015.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 21, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2, nën-paragrafi 1.3, si dhe paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/26, të datës 23 prill 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 11/28, të datës 28 gusht 2020, me Vendimin Nr. 02/12, të datës 21 maj 2021, si dhe me Vendimin Nr. 09/121, të datës 25 janar 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.4 dhe 1.5 e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/26, të datës 23 prill 2020, si në vijim:
 - 1.4. Shukrije Statovci – Eksperte Mjekësore, Oda e Mjekëve të Kosovës; anëtare;
 - 1.5. Valbona Çitaku – Përfaqësuese nga Shoqëria Civile, anëtare;
2. Mandati i anëtarëve të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit sipas pikës 1. të këtij Vendimi është mandat i ri, përkatësisht vazhdim edhe për një mandat tjetër.
3. Anëtarët i Komisionit nga pika 1. e këtij Vendimi obligohen që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, ti kryejnë në pajtim me Ligjin nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ky propozim rrjedh nga neni 21 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, nën-paragrafi 1.3, si dhe paragrafi 2 dhe 3) i Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, për faktin se anëtarëve të Komisionit i'u ka pushuar mandati i punës më datë 23 prill 2023 sipas fuqisë ligjore përkatësisht Ligjit Nr. 05/L-036 të shfuqizuar.

Andaj, duke pas për bazë të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në zbatim të nenit 41 të Ligjit Nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M
Për mbylljen e Emergjencës së Shëndetit Publik

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për mbylljen e Emergjencës së Shëndetit Publik.
2. Ministria e Shëndetësisë me Institucionet tjera përgjegjëse obligohet të vazhdoj të përcjellë situatën epidemiologjike në vend dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për menaxhimin e Pandemisë me Covid-19.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik me Nr.01/11 të datës 15 mars 2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh situatën epidemiologjike në Kosovë dhe në zbatim të rekomandimit të Institutit kombëtar për shëndetin publik të Kosovës dhe Deklaratën e OBSH-së (05 maj 2023) për heqjen e gjendjes emergjente të shëndetit publik, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/143
Datë: 24.05.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 25,800,000 € (njëzetepesë milionë e tetëqind mijë euro) për zbatimin e masës 4.4 - Mbështetja e Sigurisë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjete sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen si vijon:
 - 2.1. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me kod 214, ndahet shuma prej 7,800,000 € (shtatë milionë e tetëqind mijë euro) në nën-programin "Shërbimet e Mbështetjes" me kod 30400, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" në Projektin "Automjete të blinduara dhe automjete të veçanta" me kod 19195;
 - 2.2. Në Ministrinë e Mbrojtjes, me kod 217, ndahet shuma prej 18,000,000 € (tetëmbëdhjetë milionë euro) në nën-programin "Forca e Sigurisë së Kosovës" me kod 36000, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" në Projektin "Sisteme, pajisje dhe artikuj për mbrojtje" me kod 19072.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.10/102 të datës 26.10.2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 32,300 € (tridhjetedy mijë e treqind euro) për zbatimin e masës 4.5 – Mbështetja e Mërgatës, dhe zbatimin e pikës 1.3 dhe 1.4 të Vendimit të Qeverisë Nr.31/99 të datës 30.09.2022 në kuadër të masës 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjete sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, dhe ndahen si vijon:
 - 2.1. Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin “Thesari” me kod 11200, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, ndahet shuma prej 30,300 € (tridhjetë e mijë e treqind euro) për zbatimin e pikës 1.3 dhe 1.4 të Vendimit të Qeverisë Nr.31/99 të datës 30.09.2022, në kuadër të masës 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike;
 - 2.2. Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin “Thesari” me kod 11200, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, ndahet shuma prej 2,000 € (dymijë euro) për zbatimin e masës 4.5 – Mbështetja e Mërgatës të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në Programin përkatës për ekzekutimin e subvencionit për përfituesit e përzgjedhur sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me vendimet e veçanta të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve.

4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Ndërtesës Administrative" për nevoja të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganave të Kosovës, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinë, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Punëve të Brendshme.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/143
Datë: 24.05.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i Kompleksit Sportiv "Qendra Nacionale e Xhudos" Zona Kadastrale Pejë, Komuna e Pejës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Zyrës së Kryeministrit për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e BE-së Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat.
2. Kërkohet nga Presidentja e Republikës së Kosovës që autorizimi për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij Vendimi të jepet në përputhje me dispozitat dhe afatin e përcaktuar në nenin 7. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare trepalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III për vitet 2021-2027.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare trepalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës, Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III për vitet 2021-2027.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare trepalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III për vitet 2021-2027.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjisllacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Bashkëpunimin Kulturor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Bangladeshit.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, si në vijim:
 - 1.1. Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2023:
 - 1.1.1 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, afati i miratimit në Qeveri 30.05.2023;
 - 1.1.2 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, afati i miratimit në Qeveri 30.07.2023;
 - 1.1.3 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, afati i miratimit në Qeveri 30.07.2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore në vlerën prej 17,350.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë euro) për mbështetje të Këshillit Nacional Shqiptar dhe përfaqësuesve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në funksion të realizimit të vizitës zyrtare në Parlamentin Evropian në Strazburg të Francës.
2. Përkrahja financiare është për të mbuluar kostot e përgatitjeve, organizimit, transportit dhe akomodimit për përfaqësuesit e përzgjedhur nga Këshilli Nacional Shqiptar gjatë kësaj vizite 4 ditore.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në llogari bankare në emër të Këshillit Nacional Shqiptar.
5. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 21/140 të datës 26 prill 2023

1. Pas pikës 4. të Vendimit të Qeverisë Nr. 21/140 të datës 26 prill 2023 për aprovimin e kërkesës të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për ndarje të mjeteve buxhetore për zbatimin e masës 1.9 - Mbështetja e punësimit të personave nga komunitetet jo-shumicë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, shtohet pika 4/A si në vijim:

“4/A. Obligohet Ministri i Ministrisë për Komunitetet për Kthim të nxjerrë Vendim për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.9 - Mbështetja e punësimit të personave nga komunitetet jo-shumicë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.”

2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 21/140 të datës 26 prill 2023, mbesin të pandryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, në zbatim të Ligjit Nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Për shfuqizimin e Vendimit Nr.19/73 të datës 30 prill 2022 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh situatën epidemiologjike në Kosovë, në zbatim të rekomandimit të Institutit kombëtar për shëndetin publik të Kosovës dhe Deklaratën e OBSH-së (5 maj 2023) për heqjen e gjendjes emergjente të shëndetit publik, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë